



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronja r), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 19 paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit nr.04/L-106 për Teatrot, nenit 10.1 shkronja c) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/111-400 të datës 28 maj 2012, nenin 1 pika 3 të Rregullores për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.1/172-400 të datës 27 shtator 2012, neneve 14 dhe 19 parag. 1.18, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, neneve 16 parag. 1.2 dhe 17 parag. 2 të Statutit të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" nr.01-640-93374 dt.28.12.2016, sipas kërkesës së Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani", të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit nr. nr.01-400/03-0057207/18 të datës 19.07.2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, miratoi,

### **VENDIM**

### **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TEATRIN PUBLIK TË QYTETIT "AVDUSH HASANI" NË PODUJEVË**

#### **Neni 1**

Teatri i Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, për funksionimin dhe zhvillimin e aktiviteteve programore dhe mbulimin e shpenzimeve operative të veprimtarisë teatrale sipas objektivave strategjike përkatësisht realizimin e repertorit për vitin 2018, mbështetet me mjete financiare në shumë 12,500.00 €.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij Vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Shuma e mjeteve bartet në llogarinë bankare të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani".

#### **Neni 3**

Zbatimi i Vendimit bëhet nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-400/03-0060978/18**

**Podujevë,  
31 korrik 2018**



**Kryesuesi i Kuvendit  
Fatmir Gashi**